

## Ndal vjedhjes së orëve! Si duhet të faturohen orët e humbura?

**Moti i keq dhe vapa janë rreziqe ndërmarrësore të kompanisë dhe nuk lejohet t'u ngarkohen punëtorëve të ndërtimtarisë. Orët e humbura duhet të paguhen ose të kompensohen varësisht nga rrethanat:**

- Nëse punëtorët e ndërtimtarisë duhet të qëndrojnë në kantiere, kjo vlen si kohë pune dhe duhet të paguhet plotësisht.
- Ndërprerjet afatshkurtëra, gjatë të cilave punëtorët e ndërtimtarisë mund të shkojnë në shtëpi, mund të kompensohen me punë jashtë orarit ose këto orë mund të kompensohen në javët në vijim.
- Në rast të motit të keq, kalendari i orarit të punës mund të përshtatet për të ardhmen - por jo në mënyrë retroaktive.
- Ditët e pushimit shërbejnë për relaksim. Ato duhet të jenë të planifikueshme dhe nuk mund të përdoren për të kompensuar mungesat shkaku i motit të keq.
- Nëse kompania aplikon për kompensim nga sigurimi i motit të keq, orët e humbura llogariten si kohë pune dhe duhet të paguhen në shumën 80 përqind.
- Edhe të punësuarit e përkohshëm kanë të drejtë në pagë: Orët e humbura nuk mbulohen nga sigurimi i motit të keq, por duhet të paguhen drejtpërdrejtë dhe plotësisht nga kompania e punësimit të përkohshëm.

**A është në rrezik shëndeti dhe siguria jote?  
Apo ajo e kolegëve të tu? A duhet të punoni në kushte të rrezikshme? A janë llogaritur orët gabimisht?**

**Lajmërohu tek Unia!**

## Shëndeti është para afateve! Peticioni i punëtorëve të ndërtimtarisë dhe kryepunëtorëve për kompanitë e ndërtimit, sipërmarrësit dhe politikën

**Po ndërtohet gjithnjë e më shumë e edhe më shpejtë. Për shkak se sipërmarrësit kërkojnë afate gjithnjë e më të ngjeshura, puna shpesh vazhdon edhe në mot të keq apo në vapë përvëluese të rrezikshme.**

**Ne punëtorët e ndërtimtarisë kërkojmë që të respektohen të drejtat tona dhe shëndeti:**

- **Kontrata Kombëtare e Punës (KKP) të merret seriozisht** dhe të ndërpritet puna në mot të keq të rrezikshëm.
- **Sipërmarrësit duhet të respektojnë normën SIA-118** dhe të shtyhen afatet nëse ka vonesa për shkak të motit të keq.
- **Të bëhet kompensim i drejtë i pagës e të ketë më pak burokraci** tek sigurimi i motit të keq.
- **Të vendosen rregulla të qarta për ndërprerjen e punës** në rast të motit të keq dhe vapës së madhe.

[www.unia.ch](http://www.unia.ch)

Mëso më shumë dhe nënshkruaj peticionin



# Vapë ekstreme dhe mot i keq: Shëndeti është para afateve!

**UNIA**

**Të gjithë e dinë: Ndërtimi bëhet jashtë. Ne punëtorët e ndërtimtarisë jemi gjithashtu të gatshëm të punojmë në kushte atmosferike që nuk janë ideale. Mirëpo, kur bëhet e rrezikshme ose e padenjë, arrihen kufijtë.**



## **Ne kemi të drejta: Ndalo në rast rreziku!**

**Kontrata Kombëtare e Punës (KKP) thotë:** Në rast të kushteve atmosferike që rrezikojnë shëndetin e punonjësve, punimet ndërtimore në natyrë duhet të ndërpriten.

**Edhe Ligji e edhe urdhëresa e re për punën e ndërtimit përcaktojnë gjithashtu:** Punëdhënësi është përgjegjës për shëndetin e punëmarrësve, duhet të marrë masa mbrojtëse kundër vapës dhe motit të keq dhe të ndërpresë punën në rast rreziku.

**Për porositë që marrin parasysh standardin SIA 118 “Kushtet e përgjithshme për punimet në ndërtim”, vlen edhe me sa vijon:** Në rast të ngjarjeve të paparashikuara si moti i keq, sipërmarrësi duhet të pranojë një shtyerje të afatit dhe të heqë dorë nga penalizimi kontraktual.

**Qoftë helmetë, doreza, këpucë sigurie apo veshje mbrojtëse dhe shiu:** Sipas ligjit të gjitha veshmbathjet mbrojtëse dhe pastrimi i tyre duhet të sigurohen dhe paguhen nga punëdhënësi.

## **Të drejtat tona në të ftohtë, borë dhe shi:**

- Punëdhënësi duhet të sigurojë hapësira të ngrohta qëndrimi në të cilat mund të përgatiten pije të ngrohta dhe, nëse është e mundur, ushqime të ngrohta (KKP Shtojca 6).
- Punëdhënësi duhet të sigurojë që të nesërmen të mund të punohet me rroba të thata të punës (KKP Shtojca 6). Dhoma e pauzës dhe dhoma e zhveshjes/tharjes, duhet të jenë të ndara nga njëra-tjetra.
- Në temperatura të larta dhe erë të fortë, sipas ligjit duhet të parashikohen pushime ngrohjeje, të cilat llogariten si pjesë e kohës së punës.
- Gjatë gjithë vitit, çdo kantier duhet të ketë banjo të pastër me ujë të pijshëm dhe për çdo 20 punëtorë ndërtimtarie një tualet, të cilat duhet të pastrohen çdo ditë (KKP Shtojca 6).

## **Të drejtat tona në vapë:**

- Punëdhënësi duhet të sigurojë ujë të mjaftueshëm (ose shishe ose kroje me ujë të pijshëm) dhe pajisje mbrojtëse (mbrojtës kundër diellit, veshje mbrojtëse) dhe të organizojë vende pushimi me hije në freski.
- Orari i punës (fillon më herët, përfundon më herët, të shmangen orët jashtë orarit etj.) dhe organizimi i punës (punët e rënda në mëngjes, shmangia e punës në diellin flakërues etj.) duhet të përshtaten me temperaturat.
- Në temperaturat mbi 32°C, janë të përcaktuara pushimet shtesë prej 5 - 10 minutash çdo 1 - 2 orë. Këto llogariten në orët e punës.

Në interes të shëndetit personal, çdo punëtor ndërtimtarie këshillohet që të mbrohet me veshje të përshtatshme, kremë dielli, syze dielli dhe të pijë mjaftueshëm ujë (në ditët e nxehta të paktën 3 – 6 litra).

**Sa më shumë punëtorë ndërtimtarie dhe kryepunëtorë të jenë në sindikatë, aq më të fortë jemi ne. Ka nevojë edhe për ty!**